

KONTRATË SHITBLERJE E PJESËVE TË KAPITALIT

E lidhur në Tiranë, sot, më datë 03 mars 2022, nga dhe ndërmjet palëve te mëposhtme:

SHITESI: Z. Luan Leka, shtetas shqiptar, lindur më 06.01.1954, në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, banues në Rr “Ibrahim Rugova”, P.64, Tiranë, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 036754781, me miratimin e bashkëshortes se vet znj. **Melika Leka**, shtetase shqiptare, lindur më 1.11.1958 në Tiranë, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, banuese në Rr “Ibrahim Rugova”, P.64, Tiranë, Shqipëri, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 036752944, në vijim “*Shitësi*”;

dhe

BLERESI: Shoqëria “E. H. W.” Shpk, nje shoqëri tregtare me përgjegjësi te kufizuar, e themeluar e qe funksionon ne përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me NUIS-NIPT J61804031V dhe seli në Tiranë, superstrada Tiranë-Durrës km 4.8, e përfaqësuar rregullisht nga Administratori i vetem i saj z. **Mërkur Leka**, shtetas shqiptar, i biri i Sami dhe Aishe, lindur më 25.12.1963 në Tiranë, banues në Tiranë, Njësia Bashkiake nr. 5, në vijim “*Blerësi*”.

Në vijim Shitësi dhe Blerësi referohen veçmas si “Palë/a” dhe bashkërisht si “Palë/t”.

MEQENËSE:

- Shitësi është pronar i 100 % (njëqind për qind) të kapitalit të regjistruar të shoqërisë “Riviera Kakome” shpk me NIPT K92129027L me seli në Tiranë, në superstradën Tiranë-Durrës km 4.8, Nr.59 (ne vijim “*Shoqëria*”).
- Shitësi dëshiron ti shesë Blerësit, i cili pranon, një (1) kuotë të shoqërisë “Riviera Kakome” shpk, e cila përfaqëson 49 % (dyzet e nëntë për qind) të kapitalit të regjistruar të saj, sipas kushteve të shprehura në vijim.
- Kalimi i pronësisë sipas kesaj Kontrate eshte miratuar me me vendimin e ortakut te vetem te shoqërisë “Riviera Kakome” shpk dhe me vendimin e Asamblese se Ortakeve te Bleresit.

NË BAZË TË SA MË SIPËR, PALËT RANË DAKORD SI VIJON:

- Kundrejt çmimit te shitjes dhe me lidhjen e kesaj Kontrate Shitësi i transferon dhe kalon ne pronësinë e vetme ligjore te Blerësit dhe Blerësi blen dhe fiton pronësinë mbi një (1) kuote te kapitalit te Shoqërisë me vlere prej ALL 96.530.000 (nëntëdhjetë e gjashtë milionë e pesëqind e tridhjetë mijë lekë), qe përfaqëson 49% (dyzet e nëntë për qind) te kapitalit te Shoqërisë.
- Çmimi i shitjes se kuotës së kapitalit është i njëjtë me vlerën nominale prej ALL 96.530.000 (nëntëdhjetë e gjashtë milionë e pesëqind e tridhjetë mijë lekë). Çmimi eshte paguar ne llogarine e Shitesit sipas mandatit bashklidhur me date 03.03.2022
- Me lidhjen e kesaj Kontrate Blerësi behet ortak zotërues i 1 (një) kuote të kapitalit të Shoqërisë, qe përfaqëson 49% te kapitalit te Shoqërisë me vlere prej ALL 96.530.000 (nëntëdhjetë e gjashtë milionë e pesëqind e tridhjetë mijë lekë), ndërsa Shitësi mbetet ortak

zotërues i 1 (një) kuote të kapitalit të Shoqërisë, qe përfaqëson 51% te kapitalit te Shoqërisë me vlere prej ALL 100.470.000 (njëqind milionë e katërqind e shtatëdhjetë mijë lekë).


4. Pronësia e Blerësit mbi kuotën e kapitalit (49%) do te regjistrohet menjëherë ne librin e ortakeve dhe ne regjistrin tregtar (QKB) sipas ligjit.
5. Shitësi deklaron dhe garanton se pjesët e kapitalit te transferuara nëpërmjet kësaj Kontrate, janë ne pronësinë e vetme e te plote ligjore te Shitësit dhe janë te lira nga barra, te drejta te tjera reale apo pengje apo te drejta te çfarëdolloji te palëve te treta mbi to.
6. Blerësi deklaron dhe garanton se e njej gjendjen e Shoqërisë dhe se ka verifikuar regjistrimet e saj kontabël si dhe te drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë ne tërësi dhe për këtë nuk ka asnjë pretendim.
7. Shitësi dhe Blerësi bien dakord të nënshkruajnë dhe të paraqesin me kërkesën e parë të palës tjetër dhe/ose të Shoqërisë të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që të kryejnë të gjitha veprimet për regjistrimin e kalimit te kuotës objekt të kësaj Kontrate ne librin e ortakeve si dhe ne regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare e Biznesit si dhe në çdo autoritet tjetër sipas kërkesave te ligjit.

Kjo Kontrate u hartua në 3 (tri) kopje origjinale ne gjuhen shqipe, dhe pasi u lexua prej palëve, u gjet e rregullt, në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, u nënshkrua rregullisht nga palët si vijon:

PALËT


SHITESI

Luan Leka



Miratoi

Melika Leka



BLERESI

“E. H. W.” Shpk.

Përfaqësuar nga Administratori

Mërkur Leka

